## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **Spitali Ferizaj**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

| | |
|---|---|
| **Nr1 i prokurimit** | **220-25-331-2-1-1** |
| **Nr i brendshëm** | **001-2025** |

Sa i përket tenderit për **Lënda Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit për objektet e Spitalit me numer të Prokurimit 001-2025**

# *ANKESË*

### 1. Identifikimi i ankuesit*

*Krasniqi SH.P.K*
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

*Rr.Isa Boletini, Ulpiana, Prishtine P+8/2 nr 47, Prishtine*
*(Adresa)*

**Prishtinë** — **10 000**
*(Vendi)* — *(Kodi postar)*

*045/610/003*
*(Numri Telefonit)* — *(Numri i Faks-it)*

*Gentiana Krasniqi*
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

*shpk.krasniqi@gmail.com*
*(Adresa elektronike)*

SH.P.K. Krasniqi

*18.06.2025*
*(Data e parashtrimit të Ankeses)* — *(Nënshkrimi dhe vula)*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

_____

*(Emri i avokatit)*

_____

*(Adresa e plotë)*

_____ _____

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

_____

*(Adresa elektronike)*

_____ _____

*(Data e parashtrimit të kërkesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

1. *Njoftimi për kontrate i datës - 24.01.2025*
2. *Dosja e tenderit e datës - 05.05.2025*
3. *Hapja e tenderit - 16.05.2025*
4. *Kërkesa për Rishqyrtim - 08.06.2025*
5. *Vendimi mbi Refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim - 09.06.2025*

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐ Jo ☒

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒ Jo ☐

**6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Shkeljet e LPP-se nga ana e Autoritetit Kontraktues:**

Neni 7 - Barazia ne Trajtim Jo Diskriminimi
Neni 11- Informatat Sekrete Afariste
Neni 21- Ekonomizimi i Aktivitetit te Prokurimit
Neni 30 -Validiteti i tenderit: Pika 30.4
Neni 59 - Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve
Neni 69 - Aftesite Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 56 - Paragrafi 3 i LPP-së
Neni 72 të LPP-së

**7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Të pa kënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontrakues **'Spitali Ferizaj''** lidhur me aktivitetin e prokurimit: : **Lënda Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimitpër objektet e Spitalit me numer të Prokurimit 001-2025** ushtrojmë këtë:

# *ANKESË*

Më datë 02.06.2025, Autoritetit Kontraktues Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK për aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit për objektet e Spitalit", me nr. të prokurimit 220-25-331-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 001-2025.
Në këtë vendim, jemi njoftuar se OE i rekomanduar për kontratë është SKYFTERAT-LIVE SH.P.K., ndërsa grupi i operatorëve ekonomik 'KRASNIQI SH.P.K.' dhe 'Pro Tech Clean SH.P.K.' është eliminuar nga procedura e prokurimit për disa arsye të specifikuara në dokumentin B42.
Në cilësinë e palës me interes në këtë aktivitet të prokurimit, ne si Grup i Operatorëve Ekonomik 'KRASNIQI SH.P.K.' dhe 'Pro Tech Clean SH.P.K.' kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim, në pajtim me Nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 dhe plotësimet e tij, lidhur me vendimin e marrë për eliminimin tonë e cila është refuzuar nga ana e AK pa asnjë mbështetje ligjore.

*Në vijim po i paraqesim arsyetimet e dhëna nga ana e AK-se, lidhur me eliminimin e ofertës sonë:*
***Arsyeshmëria e parë AK-se 1:***
Në vendimin e Autoritetit Kontraktues thuhet se menaxheri i propozuar (z. Arbnor Krasniqi) nuk përmbush kriterin e përvojës pune 3 vjeçare, me arsyetimin se certifikata ISO që ka paraqitur është marrë vetëm dy muaj më parë. Sipas Dosjes së Tenderit kërkesa 8 pika b, thotë: '**OE duhet të caktojë me vendim menaxherin e kontratës, si dhe i njëjti duhet të jetë i certifikuar për menaxhimin e riskut sipas standardeve ISO, i njëjti duhet të ketë përvojë pune min. 3 vite, si dhe t'i bashkëngjitet diploma e shkollës së mesme.**'

*Pretendimi i Parë ankimor lidhur me arsyen e parë të eliminimit te ofertës sonë;*
*Bazuar ne arsyen e pare në vendimin te AK-se, japim keto sqarime:*

- *Menaxheri i kontrates eshte caktuar me vendim te Operatorit Ekonomik.*
- *I njejti eshte i certifikuar sipas standardeve ISO per menaxhim te rriskut, Certifikate e cila eshte e vlefshme dhe e cila mund te verifikohet lehtesisht permes linkut ne certifikate.*
- *Eshte bashkangjitur diploma e shkolle se mesme, kurse*
- *Sa i perket pervojes se punes, Menaxheri i kontrates ka pervoje pune mbi 3 vite e cila eshte e deshmuar me trust pensional.*

*Siç vërehet arsyeja e dhënë nga AK-se ku thotë se koha e leshimit te çertifikates per menaxhimin e rriskut ISO eshte leshuar 2 muaj me pare, si element per te kontestuar pervojen e punes, eshte jo i bazuar dhe pambështetje në kërkesën e dosjes së tenderit respektivisht LPP-se, prandaj AK qëllimisht keqinterpreton kriterin e paraqitur në dosje të tenderit e cila ka qenë:*
***"b) Operatori Ekonomik duhet te caktoj me vendim menaxherin e kontratës si dhe i njëjti duhet te jete i certifikuar për menaxhimin e riskut sipas standardeve ISO, i njëjti duhet te këtë përvojë pune min. 3 vite si dhe ti bashkëngjitet diploma e shkollës se mesme.***

*Prandaj, nuk donë mend se arsyeja e dhënë nga AK në letrën standarde, se menaxheri i prezantuar nga ana jone nuk e ka përvojën e duhur është, absolutisht tendencioz, qëllimkeq dhe joprofesional pasi që përvoja e punës është kërkuar dhe gjithmonë kërkohet pas diplomimit dhe jo pas certifikimit me EN-ISO, pra certifikimi nuk është titull akademik, por vetëm dëshmi se i njëjti posedon aftësitë e kërkuar sipas standardeve ISO. Andaj me bindje të plotë potencojmë faktin se menaxheri i prezantuar nga ana jonë është i certifikuar me ISO në menaxhimin e riskut, dhe , ka përvojën e punës prej 3 viteve pas diplomimit. Ndaj konsiderojmë se interpretimi i bërë nga AK, edhe ne vendimin për refuzimin e kërkesës sonë për ri-shqyrtim është i pambështetur në dispozitat e LPP-se, njëkohësisht është i padrejtë dhe tejkalon qartësisht përmbajtjen e kërkesës në Dosjen e Tenderit, dhe bie ndesh me nenin 56 paragrafi 3 i LPP-së i cili ndalon eliminimin e ofertës bazuar në kërkesa të cilat nuk kanë qenë të parapara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit, prandaj nga arsyeshmeria e dhënë nga AK duket çartë se komisioni i vlerësimit ka vendosur arsye apo një pjesë shtesë të kriterit që nuk ekziston në kërkesën e dosjes së tenderit.*

**Arsyeja e dytë për eliminimin e ofertës sonë nga AK-se**

Ju si OE keni vendosur nje dokument te thirrur "Etiketat e produkteve" mirepo brenda eshte thjesht nje katalog i cili permban vetem nje barkod te produktit dhe fotografi, kurse kerkesa jone etiketa e produktit jane informacione te vendosura direkt mbi produktin shishen kanaqet, kutite dhe permbajne te dhena te shkurta por te rendesishme si: emri i produktit emri i prodhuesit ose distributorit, simbolet e rrezikut, ndezshmeria, toksiciteti per mjedisin) etj.

***Pretendimi i Dytë ankimor lidhur me arsyen e eliminimit te ofertës sonë;***

*Arsyeja e dytë e dhënë AK-se nuk qëndron per faktin se, te gjitha produktet te cilat jane te paraqitura, kane etiketen, me emer te prodhuesit, me permbajtjen brenda dhe ku prodhuesi eshte i certifikuar me ISO Standard 9001:2015 dhe nuk ka qene kerkese e AK-se ku thot se kerkesa jone "etiketat e produktit" jane informacionet qe duhet te vendosen direkt mbi produktin shishe, kanaqe, kuti etj, por kerkese e AK-se eshte tek kerkesa 5: Operatori Ekonomik duhet te deklarohet se materialet jane ekologjike dhe te atestuara ndersa tek Evidenca 5: "Te deshmohet me deklarate origjinale e nenshkruar dhe e vulosur nga OE kurse kerkohet edhe MSDS dhe etiketa e produktit (kopje).*
*Pra edhe tek kjo arsye e dhënë AK manipulon qëllimisht kur thotë se kërkesa jone "etiketat e produktit" jane informacionet qe duhet te vendosen direkt mbi produktin shishe, kanaqe, kuti etj, Prandaj edhe në këtë rast komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 paragrafi 3 i LPP-së i cili ndalon eliminimin e ofertës me kërkesa te cilat nuk kanë qenë të parapara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit. Neni 56 par.3 "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".*

**Arsyeja e tretë për eliminimin e ofertës sonë nga AK-se**

Në vendimin e Autoritetit Kontraktues thuhet se marrëveshja e qirasë me "Auto Rent Graniti" SH.P.K. është e papranueshme për shkak se nuk specifikon afatin e qirasë (data e fillimit dhe përfundimit).

***Pretendimi i tretë ankimor lidhur me arsyen e eliminimit te ofertës sonë;***

*Arsyeja e dhënë nga AK-se nuk qendron sepse marreveshja e qerase eshte e lidhur me daten 05.03.2025 ndermjet paleve:*

1. *Qiradhenesi: " Auto Rent Graniti" SHPK, me NUI 812159996 perfaqesuar nga Liridona Aliu, me numer leternjoftimi: 1175748896*
2. *Qiramarresi: "Krasniqi" SHPK me NUI, 810322579 perfaqesuar nga Gentiana Krasniqi, me nr personal: 1173021719*

*Ne vazhdim po e citojme neni 2 e marreveshjes.*

*Neni2*

*Kjo marreveshje lidhet per shfrytezimin e automjeteve te lartecekura per aktivitetin e prokurimit me titull:* ***Sherbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit për objektet e Spitalit" me nr. 220-25-331-2-1-1 dhe nr. te brendshem 001-2025.***

Ndersa neni 8 i kesaj merreveshje e cek mire se kjo marrevshje hyn ne fuqi menjehere pas nenshkrimit dyja paleve.

Prandaj, nuk qendron arsyeja e dhënë nga AK në letren standarte për tenderuesin e eliminimuar. Siç vërehet me kete marreveshje, është çartësuar sakt data e fillimit e cila eshte 05.03.2025 dhe perfundon ne momentin kur perfundon ky aktivitet i prokurimit, duke pasur parasysh se kontratat kornize mund te perfondojne edhe me heret se 24 muaj.

Nuk do mend se kjo marrëveshje është hartuar **për realizimin e aktivitetit të prokurimit me titull " Sherbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit për objektet e Spitalit" me nr. 220-25-331-2-1-1, mjafton vetëm ta lexosh dokumnetin dhe e kupton** faktin që është i shënuar në vetë tekstin e marrëveshjes, tituli dhe numri i aktivitetit te prokurimit. Kjo nënkupton se afati i marrëveshjes është **i kushtëzuar drejtpërdrejt me vlefshmërinë e kontratës që do të lidhet si rezultat i këtij aktiviteti të prokurimit** – e cila sipas dosjes së tenderit është 24 muaj nga dita e nënshkrimit të saj. Për më tepër, nuk ka asnjë dispozitë në dosjen e tenderit që kërkon datën kalendarike të fillimit dhe përfundimit të qirasë – vetëm që automjetet të jenë të vlefshme gjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe të dokumentohen me marrëveshje valide me kompani të regjistruar për këtë veprimtari. Në rastin konkret komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundershtim me nein 56 par 3 i LPP-se dhe nenin 72 paragrafi I LPP-se, pasi që ka mundur të kërkoj sqarime shtesë e jo të bëjë kepinterpretimi të dokumnetit të dorëzuar nga ana jonë me të vetmin qëllimin eliminimin e ofertës sonë.

**Arsyeja e katërt për eliminimin e ofertës sonë nga AK-se**

Autoriteti Kontraktues pretendon se kalkulimet ne Analizen Financiare per Festat, Vikende dhe Nderrime te nates, nuk jane ne harmoni me ligjin e punes dhe Ligjin e ATK-se, per shkak se llogaritjet nuk korrespondojne me dispozitat ligjore, "*Kalkulimet e juaja nuk jane te sakta, ju si OE keni tentuar te veni ne lajthitje AK-ne me analizen tuaj financiare, Kostoja e cmimit per nje ore pune, nate, festave, dhe pushimeve, te llogaritura nuk jane llogaritur konform legjislacionit.*
Sipas AK-se i cili eshte thirrur ne Ligjin e punes nr.03/L-212, per festat zyrtare ne Republiken e Kosoves jane gjithsej 11 festa dhe ne total kemi 12 dite, me pas AK eshte thirrur edhe nigjin 03/L-

212 ku i percakton oret shtese per nderrimet e nates te cilat duhet te paguhen 30% gjate diteve te punes si dhe oret jashte orarit per vikende dhe festa 50%.
Vete AK pranon se keto shtesa duhet te paguhen ne perqindjen e pages baze ashtu siq e percakton edhe ligji, por nuk vepron sipas ligjit.

***Pretendimi i katërt ankimor lidhur me arsyen e eliminimit te ofertës sonë;***

*Shihet çartë se AK manipulon, edhe në këtë rast kur thotë se, OE ka tentuar te vej ne lajthitje AK-se me kete analize financiare. Themi keshtu me pergjegjesi te plote se manipulues eshte vete AK e jo ne si OE. Ne vazhdim ne do ta shpjegojme dhe qartesojme analizen financiare. Ligji e percakton se çdo pagese shtese e ndërrimeve te natës behet ne pagën baze plus duke e logaritur edhe 5% e kontributit te punedhenesit. AK, qëllimisht manipulon kur thotë se shtesat duhet te llogariten ne pagen neto, ndersa ligji i punes e percakton se keto llogaritje duhet te behen ne pagen baze. Ketu vet AK bie ne kundershtim me veten dhe ligjin sepse vete e ka potencuar se te gjitha shtesat duhet te llogariten duke u bazuar ne pagen baze e llogaritjen, vet e bene duke u bazuar ne pagen neto. Pra AK e ben perllogaritjen ne baze te pages neto prej 400 euro e qe eshte ne kundershtim me ligjin.*

*Nga llogaritja e pages neto 400 euro / 176 ore pune i bie qe per nje ore pune te paguhet 2.27 €.*
*Cmimi per oret e nates 2.27€*30% eshte 2.95 €, cmimi per ditet e festave 2.27€ *50% = 3.40€ (Përllogaritja sipas AK-se).*
*Sipas kalkulimeve te pages ne ATK dhe ligjit te punes 03/L-212, paga 400 € neto e konvertuar ne pagen bruto i bie te jete 434.78€ ne kete rast kjo eshte paga baze. Sipas ligjit dhe kalkulatorit te ATK-se paga baze eshte 434.78€. Pra kesaj page i shtohet edhe 5% e kontributit te punedhenesit qe i bie 21.74€ eshte e barabarte me 456.52€. Kjo page kur pjestohet me 176 ore pune eshte e barabarte me 2.59€. Çmimi per oret e nates 2.59 + 30% = 3.37 e jo 2.95€ ashtu siç e ka kalkuluar AK. Po ashtu per ditet e festave dhe vikendeve cmimi per nje ore pune eshte 2.59€ + 50% = 3.88€ e jo 3.40€ ashtu sic e ka llogaritur AK. Prandaj edhe në këtë rast, shihet çart se AK ka vepruar në kundërshtim me vet kërkesën e dosjes së tenderit dhe ligjin e punës me të vetmin qëllim eliminimin e ofertës sonë e cila është plotësisht e përgjegjshme.*

Në vazhdim do ti paraqesim pretendimet ankimore ndaj ofertës së OE te rekomanduar per kontratë nga ana e AK-së

Pretendimi 1

1. AK në dosje të tenderit tek kerkesa me numer 10 pika b, kishte kërkuar që; *Operatori ekonomik duhet te zotohet se do te bej furnizimin e materialit te cekura ne aneks te cekura sipas sasive te dhena Cdo fillim te muajit deri me daten 7 te muajit pasues. Kurse si dëshmi për këtë* tek evidenca nr 10 pika b ka kërkuar që; *Te deshmohet me deklarate dhe me dokumentet e shoqeruara.*

1. OE te rekomanduar per kontrate **kjo deklarate i mungon**. Sipas LPP-se kur një dokumnet I tillë I kërkuar në dosje të tenderit mungon, atëherë duhet te refuzohet tenderi pa kërkuar informacione shtes. ( pra nuk eshte përmbushur kriteri Administrativ). Në këtë rast AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 59 paragrafi 4 I LPP-se kur ka rekoamnduar për kontratë OE I cili nuk i plotëson kërkesat e parapara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit, rrejdhimisht AK **ka shkelur edhe nenin 7** gjatë procedimit të vlerësimit të ofertave pasi që ka rekomnaduar për kontratë OE I cili fare nuk ka dorëzuar deklaraten sipas kerkeses 10 pika b, kurse oferten tone e ka eliminuar me arsyetime te paqena, kjo dëshmon faktin se AK ka bërë trajtimi jo të barabartë te tenderueseve.

Përveç kësaj, Neni 57 i LPP e sqaron sakte sigurimin e tenderit sipas paragrafi 2. Nese autoriteti kontraktues vendos një kërkese per sigurimin e tenderit, kerkesa e tillë do te aplikohet për te gjithë tenderuesit. Autoriteti kontraktues do të refuzojë dhe nuk do të vlerësojë një tender të pranuar nga një tenderues që nuk e ka permbushur kushtin e depozitimit te sigurise së tenderit. Po ashtu sipas Nenit 30, te Rregullores se prokurimit publik percakton validitetin sipas paragrafit 30.1. Autoritetet kontraktuese duhet të cekin në dosjen e tenderit periudhën e vlefshmërisë së tenderit të kërkuar dhe te specifikuar si numër i diteve kalendarike nga afati i fundit për dorëzimin e tenderëve.
Autoriteti kontraktues ne Dosjen e Tenderit ka kerkuar qe Validiteti i Tenderit te jete 120 dite, ndersa OE i rekomanduar per kontrate ka dhene validitet prej 365 ditesh qe do te thote nderhyrje ne dosjen e tenderit, ndersa sigurimi i tenderit eshte 120 dite, sepse sipas Rregullores se Prokurimit Publik Neni 28.6 nese vlefshmeria e tenderit 120 dite atehere sigurimi i tenderit duhet te jete 30 dite me shume e qe i bie 150 dite.
Çdo ndryshim i periudhes se validitetit nga Dosja e tenderit e parashtruar nga nje OE konsiderohet se nuk ka arrit ti permbushe kerkesat administrativisht te ofertes dhe si te tille duhet te eleminoje si i pa pergjeshem dhe mos plotesimi i kushtit administrativ.

**Pretendimi 2**

Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka dorëzuar vlerësimin e rriskut të përpiluar me datë 29.09.2021, i cili nuk përmbush kërkesat për dokumentacion të përditësuar, në përputhje me **Rregulloren e (MPMS) Nr. 02/2021 për vlerësimin e Riskut ne Vendin e Punes.**

RREGULLORE (MPMS) Nr. 02/2021 PËR VLERËSIMIN E RISKUT NË VENDIN E PUNËS

**Neni 15**
**Shpeshtësia e vlerësimit të riskut në vendin e punës**

1. Rishikimi i vlerësimit të riskut në vendin e punës duhet të bëhet jo më pak se një herë në

[redacted]

dy (2) vjet, si dhe :

1.1. Kur fillon praktikisht një llloj tjetër aktiviteti;

1.2. Nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim në mjedisin e punës si ndryshime në procedurat e punës, metodat, pajisjet e punës, përdorimin e substancave dhe përzierjeve kimike të ndryshme, vendi i punës ka pësuar modifikime thelbësore etj;

1.3. Nëse nga Inspektorati i Punës identifikohen shkeljet e sigurisë në punë dhe akteve ligjore shëndetësore, brenda 2 (dy) javësh pas marrjes së dokumentacionit nga Inspektorati i Punës;

1.4. Nëse ka ndodhur një aksident në punë rishikimi i vlerësimi i riskut në vendin e punës duhet të përsëritet brenda 2 (dy) javësh pas aksidentit, vetëm për vendet e punës ose proceset e punës të përfshira;

Provë Vleresimi i Riskut i prezantuar nga OE i rekomanduar per kontratë

**REKOMANDIM:**

Punëdhënesi ( ***marrësi i shërbimeve*** ), duhet t'a obligoj personin e Certifikuar për SShP, apo kompaninë e licensuar për marrjen e përgjegjësive në rrafshin professional për SShP, që në vazhdimësi të kujdesët për hapësirën punuese dhe të mbikqyrë gjendjen e SShP, si dhe me kohë të ndërmarrë masat e menjëhershme për evitimin e parregullsive apo risqeve të identifikuara.

## Punëmarrësi i angazhuar nga Punëdhënesi për SSHP duhet:

- ✓ Te kujdeset për Kontrollimet Sistematike Mjekesore të Punëmarrësve.
- ✓ Sigurimin dhe mirëmbajtjen e shenjëzimit ne të gjitha hapësirat e punës.
- ✓ Te siguroj udhëzimet për punë dhe përdormin e të gjitha paisjeve të punës në mënyrë që ato të jenë të vendosura pranë paisjeve, në vende te dukshme dhe të shkruara në gjuhën të cilën e kupton Punëmarrësi.
- ✓ Te bëjë sigurimin dhe mirëmbajtjen e Pajisjeve Personale Mbrojtëse **(PPM)**.
- ✓ Të mbajë evidencen e Punëmarrësve, për vizitat mjekësore sistematike, për rastet e lëndimeve eventuale, dhe për të gjitha këto të raportoj në afat të paraparë tek organet udhëheqëse, respektivisht te Punëdhënesi.
- ✓ Për çdo Punëmarrës te punësuar për herë të parë, të bëhet trajnimi i tij për punë të sigurt (SSHP), dhe paraprakisht të njoftohet me Vlerësimin Riskut për atë vend pune, si dhe ti bëhet Kontollimi Sistematik Mjekësor pranë Institutit të Mjekësisë së Punës.
- ✓ Për çdo pozitë të re pune, të bëhen matjet e kushteve Mikroklimatike dhe matjet pajisjeve elektrike, shqyrtimin e tokëzimit mbrojtes si dhe rufepritësit dhe përfundimisht të bëhet Vlerësimi i Riskut.
- ✓ Matjet Mikroklimatike të bëhen dy herë në vit, matjet verore dhe dimerore.

Me, 29/09/2021

Ferizaj

Vlerësimin e beri:
**N.SH.T. " Trend Cmsh "**

Pranoi:
**" Skyfterat – Live " Sh.P.K.**
Njazi Syla, drejtor

Fillimisht ju njoftojmë se çasja per kete Aktivitet te prokurimit ka qene e kufizuar, prandaj per kete arsye deshmin mbi çasjen ne dokumentacion e kemi pranuar me verejte. Prove:

**SPITALI I PËRGJITHSHËM**
**FERIZAJ**

## PROCESVERBAL

*qasje në dokumentet e aktivitetit të prokurimit*

Në bazë të kërkesës së kompanisë **Grup i OE-ve: KRASNIQI SH.P.K.; Pro Tech Clean SH.P.K., Isa Boletini – Ulpiana P+8/2 Nr.47, Prishtinë** të datës 02.06.2025, Autoriteti Kontraktues Spitali i Përgjithshëm Ferizaj konform Nenit 10 të LPP-së dhe Nenit 7 të Rregullores Nr.001/2022 dhe 002/2024 për Prokurimin Publik i lejon qasje në aktivitetin e prokurimit me Titullin i kontratës: **Lënda: Shërbimi i mirëmbajtjës dhe pastrimit për objektet e Spitalit** me numër të prokurimit: **220-25-331-2-1-1** tek oferta e OE të rekomanduar për kontratë: **SKYFTERAT-LIVE SH.P.K, Rexhep Bislimi nr.1, Ferizaj** në versionin e pastruar duke larguar e mbuluar (pastruar) disa dokumente e dëshmi sipas kërkesës për konfidencialitet të pranuar nga ky operator ekonomik përmes Aneksit 3 dhe markimit (identifikimit) të disa dokumenteve në platformën e e-Prokurimit të cilat i ka klasifikuar si sekret afarist, konform Nenit 68 dhe Nenit 69 të LPP-së.

***7.6.3 Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), <u>ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal</u>, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.***

***Neni 7.7 Është përgjegjësi e AK-së për të siguruar që pjesët të cilat janë deklaruar si sekret afarist nuk janë vënë në dispozicion Operatorëve të tjerë ekonomik.***

Qasja u lejua në ora 12:30.

**Autoriteti Kontraktues**

Data: **04.06.2025**

Emri dhe mbiemri i ZPP:
**Hanushe Llabjani**

Nënshkrimi:

**Operatori Ekonomik**

Data: **04.06.2025**

Emri dhe mbiemri:

Nënshkrimi:

**PROCESVERBAL PËR LEJIMIN E QASJES NË DOKUMENTET PUBLIKE AKTIVITETIT TË PROKURIMIT**

Me vërejtje. Anozia Fjnnfgrer
4 dokument paslen dokumentin njoxu për arsyeshmëri ze ofertën e mënë lon pja tëh dokumentet sekrete afarist

Verejtja ka qene atehere kur nuk na ka dhene çasje te plote tek Analiza financiare dhe kete duke bere hijzimin e te dhenave.

Nga dokumentet te cilat na është lejuar qasja nga AK, kemi vërejtur se Operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë i mungojne disa deklarata ku janë kërkuar tek kërkesat mbi mundësite teknike dhe profesionale.

**Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale:**

- Higjienistet duhet te jene gjate orarit te punes me uniformat e siguruara nga OE. Uniforma do te identifikoj qarte punonjesin si higjienist/e i/e cili/a punon per OE, duke perfshire kartelen e identifikimit me fotografi. Uniforma duhet te jete e rregullt, e paster, si dhe te prezantoje pamje profesionale;
- Operatori ekonomik duhet te garantoj qe personeli i tyre do te kryej sherbimet ne perputhje me percaktimet e kontrates, ne interesin me te mire per objektet spitalore;
- Angazhimi i higjienisteve shtese:
  - kompania duhet çdo here te jete e gatshme per ofrimin e higjienisteve shtese;
  - angazhimi i higjienisteve behet vetem me kerkese te ekipit menaxhues te caktuar nga Autoriteti Kontraktues:
  - OE duhet te mundesoje personelit - higjienisteve shfrytezimin me pagese pushimin vjetor. Ne keto raste objektet spitalore nuk do te duhet te mbesin pa higjieniste. Prandaj, OE obligohet te kete staf shtese per te zevendesuar personelin – higjienistet gjate shfrytezimet te pushimit vjetor;
- Paga neto mujore per te gjithe te angazhuarit kerkohet te jete se paku 400.00€ ne muaj dhe ti paguhen kontributet e tjera sipas ATK (tatimi i mbajtur ne burim dhe kontributi tjeter i punedhenesit). Ne rast se gjate implementimit te kontrates, Qeveria e Republikes se Kosoves nxjerr nje vendim per pagat minimale te punetoreve te sektorit privat, OE ne bashkepunim me autoritetin do te koordinojne mundesit e rritjes sipas kerkesave ligjore.
- OE duhet te deklarohet se do te punesoje minimum 19 mirembajtes/e per kryerjen e sherbimeve si dhe 1 menaxher te punetoreve;
- Nje analize financiare e cila do te arsyetoje çmimin e dhene per kryerjen e obligimit te pagave, pagesen e kontributeve, tatimeve, TVSH si dhe detyrimeve tjera.
- OE duhet te deklarohet se pagat e punetoreve do te paguaj per muajin paraprak, me se largu deri me date 07 te muajit ne vijim, pa marr parasysh pagesen e bere nga AK.
- OE duhet te deklarohet se te drejtat dhe detyrat e punetoreve do te mbesin pergjegjesi e tyre para organeve dhe institucioneve te Republikes se Kosoves;

Bazuar ne kerkesat mbi mundesite teknike dhe profesionale, Operatori ekonomik te rekomanduar per kontrate i mungojne deklaratat e hijezuara te cekura me larte.

Autoriteti Kontraktues nuk i ka kerkuar Operatorit ekonomik te rekomanduar per kontrate nje vertetim mbi kryerjen e obligimeve ndaj KK per vitin 2024, ky vertetim ka qene tek kerkesat e pershtatshmerise pika 6.4.: Provë:

***Evidenca 1.Nje deklarate e shkruar nen Betim, e nenshkruar nga tenderuesi duke perdorur formen ne Aneksin 2 te kesaj dosje te tenderit. Deshmite lidhur me kerkesat e pranueshmerise do te kerkohen nga tenderuesi te cilit Spitali i Ferizajt, ka nder mend qe t'ia jap kontraten. Deshtimi per te paraqitur nje nga keto dokumente brenda afatit kohor te permendur, do te thote qe tenderuesi do te refuzohet, do t'i konfiskohet garancioni i sigurimit te ofertes dhe AK do te vazhdoje me tenderuesin e radhes ne rang-liste. Dokumentet te cilat do te kerkohen si deshmi per permbushje te kerkesave te pranueshmerise jane me sa vijon Një vërtetim nga ATK në vendin e themelimit të OE se OE në fjalë nuk është me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Vlen për OE fitues, OE fitues dëshminë e tille duhet ta dorëzoj para Publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetet Kontraktues Një vërtetim mbi kryerjen e obligimeve ndaj KK-së për vitin 2024 vlen për OE fitues, OE fitues dëshminë e tille duhet ta dorëzoj para Publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e***

*Autoritetet Kontraktues Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se OE nuk është i falimentuar apo likuiduar ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore te lëshuar nga Gjykata. Vlen për OE fitues, OE fitues dëshminë e tille duhet ta dorëzoj para Publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetet Kontraktues. Deshtimi i Operatorit Ekonomik qe eshte propozuar qe te shperblehet me kontrate te sjell dokumentet te kerkuara i jep te drejte Autoritetit Kontraktues qe oferten ta refuzoj, ta beje konfiskimin e garancionit per sigurim te ofertes dhe te vazhdoj me shperblim te kontrates me Operatorin Ekonomik qe eshte rendit ne vendin e dyte e keshtu me radhe.SHENIM ME RENDESI (OBLIGATIVE) a.Kompanite e huaja pjesemarrese ne proces duhet te jene te regjistruara sipas Ligjeve ne Fuqi te Republikes se Kosoves, per te hyre ne kontrate. b.Operatori Ekonomik, fituesi i kontrates (OE) obligohet qe me rastin e nenshkrimit te kontrates te sjel1 me vete nje polis te sigurimit per heqjen e pergjegjesise publike dhe profesionale minimum 100,000.00 € (njeqind mije euro), per periudhe kohore deri ne perfundimin e kontrates, leshuar nga kompanite e sigurimeve ne Kosove, ne te kunderten kontrata nuk mund te fuqizohet! c. Paga minimale neto baze per punetoret e pastrimit te angazhuar ne kete kontrate duhet te jete ne shume prej 400€. Operatori Ekonomik eshte i obliguar qe te rrespektoj çdo Vendim tjeter ne lidhje me pagat minimale qe mund te mirret ne te ardhmen dhe gjate kohes se ekzekutimit te kesaj Kontrate. AK nese paga minimale do te tejkalon vleren minimale te caktuar ateher do te ia kompenzoj OE-se ne baze te ligjeve ne fuqi!*

Autoriteti Kontraktues nuk i ka kërkuar fare Nënkontraktorit dokumentacionin përkatës, i cili është i detyrueshëm të kërkohej me rastin e njoftimit për dhënie të kontratës, ashtu siç parashihet në paragrafi 6.4 të FDT-së.

- Certifikaten e leshuar nga Gjykata dhe
- Vetetimin e ATK-se.

Nga sa u tha më lartë vërehet se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 4 i LPP-së nenin 69 LPP-se, nenin 7 të LPP-së dhe nenin 65 të LPP-se pasi që ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e parapara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit të paraqitura nga ana e AK-se tek kërkesat e përshtatshmërisë teknik dhe profesional dhe tek kërkesat e përshtatshmërisë, duke mos dorëzuar fare dëshmitë për nën-kontraktonin. Me qe shkeljet kane te bëjnë me mungesa të tilla të cilat i kemi elboruara me lartë, duke i hijezuar edhe me ngjyre të verdh, atëherë kjo konsiderohet shkelje e plotë e dispozitave të lartcekura të LPP-së.

Sa i perket Operatoreve Ekonomik Schaferberger JR GMBH Dega Kosove dhe Erik SH.P.K ata jane eleminuar per disa arsyje, mirepo ne sa kemi pasur qasje ne dokumentacion kemi verejtur se deklaratat e Operatorit Ekonomik Erik SHPK jane te vulosuar me vulen e Schaferberger JR GMBH Dega – Kosove.

prezentojnë një tender si individual dhe si anëtar të një grupi në të njejën kohë në një aktivitet të prokurimit

DEKLARATË

Unë i poshtë nënshkruari, në përfaqësi OE: Erik SHPK me anë të këtyi deklarate, deklarohet me vetëdijesi të plotë se pasoi e punëtorve do te punohen për nevojën personale, me sa lergu dhënë me date 07 te majit me vijim po marr parasysh pasojat e bëra nga AK per aktivitetin me titull: Lënda Shërbimi i mirëmbajtjës dhe pastrimit për objektet e Spitalit Me numer të Prokurimit 001-2025 dhe nr.prokurimit 220-25-331-2-1-1 & 001-2025

OE:ERIK SHPK

Vula

Schaferberger jr. GmbH

DEKLARATË

Unë i poshtë nënshkruari, në përfaqësi Kompanisë OE: Erik SHPK & Schaferberger JR GMBH Dega Kosovë me anë të këtyi deklarate, deklarohet se punëtorët e punësuar janë eliminuar dhe ky eliminim bëhet nga aktiviteti Lënda Shërbimi i mirëmbajtjës dhe pastrimit për objektet e Spitalit Me numer të Prokurimit 001-2025

Operatori Ekonomik Schaferberger JR GMBH Dega Kosove është eleminuar për shkak se nuk i ka pasur disa dokumente ashtu siç janë kërkuar në dosjen e tenderit:

1. I mungon certifikata
2. per menaxhim te rrikut per menaxherin, që është kusht administrativ dhe eleminon OE nga aktiviteti.

Besojmë se i kemi elaboruar më shumë se që duhet shkeljet e AK-së në këtë aktivitet të prokurimit andaj, kërkojmë nga OSHP që pretendimet tona ti konstatoj të bazuara dhe të nxjerr:

## V E N D I M

**APROVOHET** si e bazuar Ankesa e grupit të Operatorit Ekonomik : ''Krasniqi'' SH.P.K. dhe Pro Tech Clean SH.P.K ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: **" Lënda Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimitpër objektet e Spitalit me numer të Prokurimit 001-2025** , te iniciuar nga Spitali Ferizaj, me nr. te prokurimit **220-25-331-2-1-1 dhe atë;**

**ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues i datës 02.06.2025 për shpalljen e OE SKYFTERAT-LIVE SHPK dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim.**

Po ashtu kërkohet nga OSHP që të obligoj AK-në që ri-vlerësimin e ofertave ta bëjë bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, e që realisht më pas do të duhet që fitues të shpallet grupi i OE "Krasniqi" SH.P.K. dhe Pro Tech Clean SH.P.K.

**8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Demet materiale kapin shumen rreth 6,000 euro.**

**9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*